



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E ARSIMIT
 SPORTIT DHE RINISË**
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2019
ME ZGJEDHJE

Lënda: Gjeografi

Model Testi

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **60 pikë**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim**.

Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa									
Pikët									
Kërkesa									
Pikët									
Kërkesa									
Pikët									

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

1. Figura është marrë nga një satelit i motit nëpërmjet rrezeve infra të kuqe. Çfarë tregon zona me pjesën më të errët?

1 pikë


- A) Mbulesë më të hollë të reve;
- B) Rymat oqeanike;
- C) Hijen e Hënës;
- D) Natën.



2. Cila nga figurat tregon vendosjen e Diellit, Tokës dhe Hënës gjatë një Eklipsi Hënor?

1 pikë

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4



3. Figura 1 tregon pozicionin e Tokës përkundrejt Diellit në një ditë të caktuar të vitit. Pikat nga A në E tregojnë disa vende në sipërfaqen e Tokës. Vija e ndërprerë tregon boshtin e Tokës. Cila nga pjesët e figurës 2 jep në mënyrë të saktë këndin e rënies së rrezeve të Diellit në pikën C?

1 pikë

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

Fig. 1






Fig. 2




4. Londra dhe Irkutsk gjenden pothuajse në të njëjtën gjerësi gjeografike. Cili është faktori kryesor që qyteti i Londrës ka klimë më të butë se sa qyteti Irkutsk?

- A) Liqeni që ndodhet pranë Irkutsk bën që klima atje të jetë më e ftohtë.
- B) Irkutsk ka më pak bimësi se Londra.
- C) Rrymat e ngrohta oqeanike ndikojnë në zbutjen e klimës në Londër.
- D) Malet e lartë pranë Londrës bllokojnë rrymat e ftohta të depërtojnë në qytet.



1 pikë


← Rryma oqeanike të ftohta ← Rryma oqeanike të ngrohta
Temperaturat mesatare mujore



5. Faza e fundit e formimit të deltës lumore pasqyrohet në figurën e emërtuar me shkronjën:

- A) A
- B) B
- C) C
- D) D

Formimi i deltës lumore



1 pikë

6. Cilën nga vetitë fizike të mineraleve përcakton Shkalla e Mosit?

- A) Ngjyrën;
- B) Fortësinë;
- C) Shkëlqimin;
- D) Dendësinë.

1 pikë

7. Cilin nga proceset gjeologjike tregon figura e dhënë?


- A) Shkëputjen tektonike;
- B) Tjetërsimin fizik;
- C) Metamorfizmin;
- D) Rrëshqitjen.



1 pikë


8. Në një ditë pa erë, temperatura e ajrit jashtë shtëpisë është 10°C, ndërsa brenda shtëpisë është 18°C.

a) Cila nga figurat e paraqet në mënyrë të qartë modelin e qarkullimit të ajrit, nëse dritarja e shtëpisë është e hapur?



1 pikë


b) Argumentoni përgjigjen tuaj.



2 pikë

9. Korja tokësore përfshihet nga lloje të ndryshme lëvizjesh.

a) Emërtoni format e relievit që formohen nga lëvizjet e kores tokësore që përfaqësojnë shkronjat A në figurën 1 dhe në figurën 2.




2 pikë

Për figurën 1

Shkronja A: _____

Për figurën 2

Shkronja A: _____



1 pikë

b) Çfarë kanë të përbashkët këto lloj lëvizjesh?

c) Identifikoni një ndryshim midis këtyre lloj lëvizjeve.

1 pikë


10. Vëzhgoni me kujdes hartën e dhënë dhe përcaktoni:

a) Llojin e hartës.

b) Në cilën pikë rrjedh lumi më shpejt? Jepni një argument për të mbështetur përgjigjen tuaj.

Lumi rrjedh më shpejt në pikën: _____

Argumenti: _____



1 pikë

2 pikë

11. Shkëmbinj të ndryshëm, në varësi të përbërjes së tyre dhe kushteve në të cilët ata ndodhen, formojnë peizazhe të ndryshme.

a) Emërtoni llojin e peizazhit në figurën e mëposhtme. 1 pikë

b) Identifikoni tre nga kushtet në të cilat mund të ndodhë formimi i një peizazhi të tillë. 3 pikë



c) Çfarë duhet të marrin në konsideratë ndërtuesit kur ndërtojnë në këto zona? 1 pikë

12. Rruga e cila lidhte Durrësin me Dibrën e Madhe ishte:

1 pikë

- A) rruga e Arbrit;
- B) rruga e Vjosës;
- C) rruga e Drinit;
- D) rruga e Veriut.

13. Medvegja është një nga krahinat e trevave shqiptare, që ndodhet në përbërje të:

1 pikë

- A) Serbisë;
- B) Kosovës;
- C) Malit të Zi;
- D) Ish R.J. të Maqedonisë.

14. Vendbanimet shqiptare në formën e kalave janë karakteristike për periudhën e:

1 pikë

- A) Antikitetit;
- B) Mesjetës;
- C) Mbretit Zog;
- D) Luftës së Dytë Botërore.

15. Rajoni me sipërfaqen më të madhe në Republikën e Shqipërisë është:

1 pikë

- A) Rajoni Verior – Verilindor;
- B) Rajoni Perëndimor;
- C) Rajoni Juglindor;
- D) Rajoni Jugor.

16. Dendësia më e madhe e popullsisë në trevat shqiptare është në:

1 pikë

- A) Shqipëri;
- B) Kosovë;
- C) Trevat shqiptare në Mal të Zi;
- D) Trevat shqiptare në Maqedoni.

17. Një nga pasojat sociale të pabarazisë së zhvillimit në Shqipëri është:

1 pikë

- A) mbipopullimi;
- B) ndotja e mjedisit;
- C) lindjet e pakta;
- D) ndërtimet joformale.

18. Fotoja tregon pamje nga një zonë, ku kanë ndodhur rrëshqitje të dherave.

a) Në cilët lloj shkëmbinjsh ndodhin rrëshqitjet?

1 pikë

b) Identifikoni dy shenja paralajmërimi në zonat ku ndodhin rrëshqitjet.

2 pikë



19. Krahasoni veçoritë e zhvillimit ekonomik në RSH në periudhën 1945 – 1990 me atë të pas viteve '90 të shek. XX. Gjeni tre ndryshime mes tyre.

3 pikë

Ekonomia në periudhën 1945-1990	Ekonomia pas viteve '90
1.	1.
2.	2.
3.	3.

20. Republika e Shqipërisë ndahet në katër rajone gjeografikë.

- a) Në hartën fizike të Shqipërisë përcaktoni (me stilolaps, me përafërsi) vijën e kufijve të rajoneve gjeografikë të Republikës së Shqipërisë.
- b) Cili është kufiri jugor i Rajonit Verior-Verilindor?

- c) Përcaktoni llojin e shkëmbinjve që mbizotëron në Alpet Shqiptare.

- d) Identifikoni një nga pjesët përbërëse të rajonit Verior-Verilindor që përbëhet kryesisht nga shkëmbinj magmatikë.

- e) Në cilat zona të Alpeve Shqiptare është vendosur më shumë popullsia? Jepni një nga arsyet.



1 pikë

1 pikë

1 pikë

1 pikë

2 pikë

21. Hinduizmi është besim fetar:

- A) universal;
B) etnik;
C) tribal;
D) evropian.

1 pikë

22. Rreth $\frac{1}{4}$ e territorit të Evropës përbëhet nga:

- A) fusha;
B) kodra;
C) pllaja;
D) male.

1 pikë


23. India është pjesë e rajonit të:

- A) Azisë Lindore;
B) Azisë Jugore;
C) Azisë Juglindore;
D) Azisë Qendrore.

1 pikë

24. Duke u bazuar në figurën e dhënë, cilët shtete janë më të predispozuar për të pasur konflikt lidhur me pasuritë natyrore që zotërojnë?

- A) Shteti A dhe shteti D;
- B) Shteti C dhe shteti D;
- C) Shteti A dhe shteti B;
- D) Shteti B dhe shteti C.



1 pikë

25. Numri 4 në hartën e mëposhtme tregon:

- A) lumin Shën Lorenc;
- B) lumin Rio Grande;
- C) lumin Kolorado;
- D) lumin Kolumbia.

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS DHE KANADAJA




1 pikë

26. Japonia shet makina në SHBA, vetë SHBA eksporton teknologjinë e lartë në Arabinë Saudite dhe Arabia Saudite eksporton naftë në Japoni. Cili është përfundimi i saktë që mund të jepet për këtë fjalë? 1 pikë

- A) SHBA është eksportuesi kryesor botëror.
- B) Arabia Saudite kontrollon pjesën më të madhe të burimeve natyrore.
- C) Shumë vende në botë janë të specializuara vetëm në një lloj eksporti.
- D) Vendet në botë janë ekonomikisht të ndërvarrura nga njëra – tjetra.

27. Qarkullimi i cilit produkt të rëndësishëm është pasqyruar në hartën e mëposhtme?

- A) Diamantit;
- B) Tekstil;
- C) Miellit;
- D) Naftës.



1 pikë

28. Vëzhgoni me kujdes tabelën e mëposhtme. Ajo tregon parashikimet për rritjen e popullsisë mbi moshën 65 vjeç. Mosha mesatare e popullsisë në vendet e përzgjedhura po rritet ndjeshëm.

Shtetet	Pop. mbi 65 vjeç, në % - viti 2000	Pop. mbi 65 vjeç, në % - viti 2050
Belgjika	17	28
Danimarka	15	24
Japonia	17	32
Rusia	13	25
Ukraina	14	27
Britania e Madhe	16	25

a) Nxirni dy arsye pse moshë mesatare e popullsisë në vendet e përzgjedhura po rritet ndjeshëm. 2 pikë

Arsyeja 1 _____


Arsyeja 2 _____

b) Identifikoni një pasojë sociale të vendeve që vuajnë nga plakja e popullsisë. 1 pikë

c) Identifikoni një pasojë ekonomike të vendeve që vuajnë nga plakja e popullsisë. 1 pikë


29. Figura e mëposhtme tregon piramidat moshore të popullsisë së shteteve të ndryshme.

a) Cila është piramida moshore që tregon një rritje të shpejtë të popullsisë?



1 pikë

b) Jepni tre argumente për të mbështetur përgjigjen tuaj.



3 pikë

c) Për cilat vende është karakteristike piramida moshore që ju zgjidhet në kërkesën a? 1 pikë

30. Suksesi i industrializimit u shoqërua me probleme të mëdha mjedisore në gjithë botën. Me fillimin e shekullit XXI disa shtete janë përpjekur t'i marrin në konsideratë këto probleme.

Analizoni problemet mjedisore që industrializimi i ka shkaktuar vendeve të botës dhe se si këto vende po përpiqen të reduktojnë pasojat e shkaktuara nga industrializimi.

4 pikë

Shënim: Këto faqe mund të përdoren nga nxënësi për shënime, por nuk do të vlerësohen.

